



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKISË

V E N D I M

Nr. 36, datë 31/05/2022



“Miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastrë, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. **Skifter Murataj** i cili është dëmtuar nga djegia e banesës së tija private si rezultat i rënies së zjarrit .

Baza Ligjore

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore, ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore “, Udhëzimin nr. 09, date 23.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin 9/1 date 20.03.2018, dhe udhëzimin nr. 1 datë 10.01.2022 pjesë përbërëse për zbatimin e buxheti për vitin 2022, VKB nr. 107, datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit 2022”, V.K.M Nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprime njerëzore”.

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Gjirokastrë për mbështetjen financiare për shtetasin, Z. **Skifter Murataj** , për dëmtimet e banesës së tij si pasojë e djegies.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Gjirokastrë .
3. Ti akordojë familjes së shtetasit **Skifter Murataj** , ndihmë financiare në vlerën prej **200.000 lekë** duke pakësuar Gr.00 tit 03280 kap1Art. 602 dhe të shtohet Gr.00tit 03280kap.1.Art.6029099, nga

buxheti i Bashkisë Gjirokastrër, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2022.

4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit **Skifter Murataj**, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329, datë 16.5.2012.

5. Ndihma financiare që do të akordohet dot përdoret për krijimin e kushteve për jetesë nga **Z. Skifter Murataj**, banesa e të cilës është dëmtuar.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Etleva Yzo



Kryetari i Këshillit Bashkisë

Lavdi Hasani

